

UNIVERSITETI “NËNË TEREZA” NË SHKUP
УНИВЕРЗИТЕТ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ ВО СКОПЈЕ
MOTHER TERESA UNIVERSITY IN SKOPJE



Informatori Publik "Pulsi i UNT-së"

Semestri Dimëror 2025

Raport mbi zhvillimin institucional, arritjet akademike dhe jeta studentore
periudha: Shtator - Dhjetor 2025

Të nderuar studentë, kolegë dhe partnerë të Universitetit,

Ky dokument që keni përpara nuk është thjesht një kronikë datash dhe ngjarjesh, por është dëshmia e gjallë e një organizmi akademik që rritet me ritme të shpejta. Titulli "Puls i UNT-së" pasqyron pikërisht këtë: ritmin e pandalshëm të punës, inovacionit dhe përkushtimit që karakterizon Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup.

Viti 2025 shënoi një kthesë strategjike për institucionin tonë, duke u pozicionuar si një qendër e rëndësishme e transformimit digjital dhe hapjes ndërkombëtare. Ne nuk jemi thjesht një hapësirë ku jepet dije, por një ekosistem ku dija shndërrohet në veprim. Nga sallat e ligjëratave në zemër të Shkupit e deri te qendrat kërkimore prestigjioze në mbarë botën, emri i UNT-së këtë semestër ka rezonuar përmes sukseseve të jashtëzakonshme të stafit tonë akademik dhe energjisë kreative të studentëve.

Gjatë këtij semestri dimëror, ne kemi arritur të ndërtojmë ura të reja bashkëpunimi:

- ❖ Në rrafshin shkencor: Përmes konferencave që mbledhën mendjet më të ndritura të rajonit dhe më gjerë.
- ❖ Në rrafshin institucional: Përmes takimeve strategjike të Rektoratit që forcuan profilin tonë diplomatik dhe akademik.
- ❖ Në rrafshin praktik: Përmes vizitave studimore dhe trajnimeve që i përgatisin studentët tanë për sfidat e tregut global.

Ky raport përmbledh rrugëtimin tonë katërmujor, filluar nga nismat e muajit Shtator e deri te përmbyllja dinamike e Dhjetorit 2025. Ju ftojme të shfletoni këto faqe që pasqyrojnë angazhimin tonë të përbashkët për të bërë UNT-në një bastion të dritës, shkencës dhe progresit shoqëror.

Të gjitha ngjarjet janë të mbledhura kuadër kalendarit të aktiviteteve ditore.



1. Hyrje e Përgjithshme

Periodha shtator–dhjetor 2025 shënon një të katërmujorit më të dendur në historinë e shkurtër, por intensive, të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup (UNT). Dokumenti i titulluar “Puls i UNT-së”, regjistron më shumë se gjashtëdhjetë aktivitete të veqanta institucionale, akademike dhe studentore, duke përbërë një panoramë të gjithanshme të ritmit të punës së këtij universiteti publik. Nuk është thjesht një listë ngjarjesh. Është një hartë e lidhshmërisë institucionale që tregon se si një universitet relativisht i ri (në vitin e njëjtë të ekzistencës) po ndërton identitetin e vet nëpërmjet veprimtarisë së palodhur.

Viti akademik 2025/2026 nisi me 1040 studentë të regjistruar, një shifrë që për herë të parë kalon pragën e njëmijëshës. Ky fakt, në vetvete, sinjalizon një tendencë rritjeje që nuk mund të shpjegohet vetëm me faktorë demografikë, por lidhet ngushtë me kredibilitetin në rritje të institucionit, hapërimin ndërkombëtar dhe diversifikimin e programeve studimore. Në të njëjtën kohë, UNT-ja ka firmosur mbi pesëmbëdhjetë memorandume bashkëpunimi gjatë këtij semestri, ka organizuar konferenca ndërkombëtare me pjesëmarrje nga më shumë se gjashtë shtete, dhe ka dërguar studentë e staf akademik në forume shkencore në Stamboll, Krakov, Tiranë, Novi Sad dhe Prishtinë.

Kjo analizë strukturohet në shtatë kategori kryesore, secila e ndërtuar mbi bazën e të dhënave të dokumentit origjinal: diplomacia akademike dhe takimet e rektoratit, marrëveshjet e bashkëpunimit, konferencat shkencore, jeta studentore dhe arritjet sportive, publikimet dhe promovimet akademike, inovacioni dhe zhvillimi i qëndrueshëm, si dhe ngjarjet kulturore e komemorative. Qëllimi nuk është vetëm të përshkruajë që ka ndodhur, por të interpretojë se çfarë kuptime institucionale nxjerrim nga kjo dinamikë.

2. Diplomacia Akademike dhe Takimet Strategjike të Rektoratit

Një nga karakteristikat më të dukshme të këtij katërmujori është intensiteti i madh i takimeve diplomatike dhe institucionale që ka zhvilluar rektori Prof. Dr. Bekim Fetaji. Në një përqindje të konsiderueshme të aktiviteteve të regjistruara, i një rrjeti ndërlidhjesh që shtërhet nga ambasadat e huaja në Shkup deri tek organizatat ndërkombëtare.

Takimet me përfaqësues diplomatikë përfshijnë miratime zyrtare me Ambasadorin e Japonisë, Setsuko Kawahara, përfaqësues të Ambasadës Amerikane, Ambasadën e Zvicërrës, si dhe dy takime të veqanta me Ambasadën Gjermane, njëri me rastin e Ditës së Bashkimit të Gjermanisë dhe tjetri për diskutime mbi mundësitë e bashkëpunimit akademik me DAAD-in. Kjo shtresëzim diplomatik tregon një qëndrueshmëri të qartë në strategjinë e jashtme të UNT-së: universiteti nuk pret që ndërkombëtarizimi të vijë vetëm, por shkon drejt tij.

Në planin institucional vendës, rektori Fetaji u takua me kryetarin e Kuvendit të RMV-së Afrim Gashi, zëvendësministrin e Arsimit Lulzim Aliu, kryetarin e Komunës Çair Izet Mexhiti, si dhe mori pjesë në seancën e Këshillit Nacional për Zhvillim të kryesuar nga Kryeministri Mickoski. Këto takime sinjalizojnë që UNT po pozicionohet jo vetëm si një institucion arsimor, por si një zë që kërkon vend në vendimmarrjen strategjike kombëtare për arsimin e lartë.



Vizitat ndërkombëtare të rektoratit përfshijnë takime me rektorët e universiteteve të Marmarasë, Istanbul Medeniyet, Shkodrës, Shën Kliment Ohridski në Manastir dhe Kadri Zeka në Gjilan. Për më tepër, takimet online me Universitetin e Norvegjisë Juglindore (Prof. Dr. Glenn Agung Hole) tregojnë se diplomacia akademike e UNT-së ka kaluar kufijtë gjeografikë tradicionalë të rajonit. Në një dimension të ndryshëm, takimet me UNOPS (Kalinka Gaber), Bankën Botërore (Bojana Naceva) dhe koordinatoren e OKB-së Rita Columbia sugjerojnë një orientim të qartë drejt agjendave zhvillimore globale.

Një vëzhgim analitik që del nga ky tablo: rektori Fetaji ka përqendruar në vetvete një volum të madh ndërlidhjesh institucionale. Kjo mund të jetë një pikë fortë (koherencë në mesazhin e jashtëm), por njëkohësisht ngre pyetjen nëse ndërkombëtarizimi i UNT-së do të mundë të qëndronte me të njëjtin ritëm në rast se kjo bartë diplomatike nuk decentralizohet gradualisht drejt dekanëve dhe strukturave të tjera akademike.

3. Marrëveshjet dhe Memorandumet e Bashkëpunimit

Gjatë periudhës shtator–dhjetor 2025, UNT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm memorandumesh bashkëpunimi, të cilët shtrihen në disa dimensione: akademikë, industrialë, kulturorë dhe institucionalë. Kjo shumëllojshmëri nuk është aksidentale. Ajo pasqyron një strategji të qartë për diversifikimin e partneriteteve përtej botës akademike tradicionale.

Partner	Lloji	Fokusi kryesor
Sh.M.Q.Sh “Arseni Jovkov”	<i>Arsimor</i>	Praktika profesionale, shkëmbime arsimore
Universiteti Istanbul Medeniyet	<i>Akademik</i>	Bashkëpunim akademik dhe shkencor
Universiteti i Shkodrës	<i>Akademik</i>	Shkëmbim profesorësh, studentësh, kërkimi
Avant Car (“Avant2Go”)	<i>Industrial</i>	Mobilitet i gjelbër, transport urban
UNIPROMET, Çaçak (Serbi)	<i>Industrial</i>	Bashkëpunim strategjik teknologjik
EGoS (Organizata Evropiane e Gjeodetëve)	<i>Shkencor</i>	Kërkim shkencor, programe arsimore
GeoSensors – AlbMatrix, Tiranë	<i>Teknologjik</i>	Projekte inovative teknologjike
AZGj + Muzeu i Alfabetit (trepalësh)	<i>Kulturor</i>	Partneritet akademik, kulturor, kërkimor
EKOFLUID	<i>Ekologjik</i>	Riciklim, praktika mjedisore

Komisioni i Letrave me Vlerë	<i>Financiar</i>	Edukim profesional, tregu i kapitalit
Kabineti i Zëvendëskryeministrit	<i>Institucional</i>	Qeverisje e mirë, praktikë profesionale

Spektri i partnerëve është i gjerë: nga universitete turke (Istanbul Medeniyet, Marmara) dhe shqiptare (Shkodra), deri tek kompani private si Avant Car (mobilitet i gjelbër), UNIPROMET (Serbi), EVN Maqedoni dhe EKOFLUID (riciklim vajrash). Memorandumi trepalësh me Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës dhe Muzeun e Alfabetit përbën një risi të veçantë, duke shkruar dimensionin kulturor me atë akademik në një kuadër të vetëm institucional. Po ashtu, memorandumi me Komisionin e Letrave me Vlerë hap terren për edukimin financiar, një fushë që rrallë adresohet në marrëveshjet universitare në rajon.

Megjithatë, një pyetje mbetet legjitime: sa nga këto memorandume do të prodhojnë rezultate të matshme? Memorandumi, si instrument juridik, është një deklaratë vullneti; ai nuk garanton veprim. Do të ishte e dobishme që UNT të vendoste një mekanizëm monitorimi për secilin memorandum, me indikatorë të qartë për zbatimin e tyre brenda një afati kohor të caktuar.

4. Konferencat Shkencore dhe Prodhimi Akademik

Semestri dimëror 2025 shënoi një aktivitet të dendur konferencor që përforcon pretendimet e UNT-së për të qenë një qendër e prodhimit shkencor e jo vetëm e transmetimit të dijes. Në këtë periudhë, universiteti organizoi ose bashkëorganizoi të paktën tre konferenca të mëdha ndërkombëtare, secila me profil të dallueshëm.

Konferenca Ndërkombëtare për Gjeodezinë dhe Kartografinë, e mbajtur më 31 tetor, solli në UNT përfaqësues të organizatave botërore FIG dhe ICA, së bashku me EGoS, asociacione kombëtare të gjeodetëve nga Bullgaria, Kroacia, Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Kjo nuk është një konferencë e zakonshme rajonale; prania e trupave ndërkombëtare me ndikim global në fushën e gjeoshkencave e pozicionon UNT-në si nikoqir serioz në këtë disiplinë.

Edicioni i 9-të i Konferencës Ndërkombëtare për Migracionin (20 nëntor) mbledhi mbi pesëdhjetë studiues nga vendi, rajoni dhe Azia, me 36 punime të aprovuara nga mbi 50 aplikime. Ky raport selektimi (përafërsisht 72%) tregon një nivel të arsyeshëm të filtrit akademik. Konferenca e tretë e madhe, Kongresi i III-të për Zhvillim të Qëndrueshëm “TSD 2025” (15 dhjetor), mbledhi akademikë dhe ekspertë ndërkombëtarë për të diskutuar qështje të inovacionit shkencor dhe sfidave globale.

Jashtë mureve të UNT-së, rektori Fetaji u paraqit si Folës Kryesor (Keynote Speaker) në Konferencën e 8-të Botërore mbi Të Dhënat e Mëdha dhe Informatikën Inteligjente në Turqi (14 nëntor), një fakt që përforcon profilin shkencor individual të udhëheqësit akademik të institucionit. Konferenca Shkencore e 28 Nëntorit, e organizuar për të dytin vit radhazi në bashkëpunim me Fondacionin AXIS, solli në tryezë diskutime historike, politike dhe kulturore mbi shqiptarët në Maqedoninë e Veriut.

Përtej konferencave, pjesëmarrja aktive e stafit akademik në projekte si HEI2MARKET (Stamboll e Krakov, nën iniciativën EIT), konferenca përmbyllëse e projektit COUTURE në Tiranë (Erasmus+), seminari mbi Web of Science, si dhe ligjërata e Prof. Glenn Hole mbi sipërmarrjen dhe inovacionin tregojnë një ekosistem të



gjallë shkencor ku UNT nuk është vetëm organizator, por edhe pjesëmarrës aktiv në rrjete ndërkombëtare të kërkimit.

5. Jeta Studentore, Vizitat Studimore dhe Arritjet Sportive

Në një analizë të thelluar, jeta studentore shërben si test litmus për shëndetin real të një institucioni arsimor. Në UNT, këtë semestër, ajo paraqitet e pasur dhe e shumëdimensionale.

Vizitat studimore përbëjnë një shtyllë të fortë: studentët e Fakultetit Ekonomik vizituan Bankën Popullore dhe Institutin e Kontabilistëve; studentët e Kriminalistikës realizuan trajnime në Kazermën “Ilinden”, vizituan Muzeun e Kriminalistikës (me mbi 3000 ekspozate), Prokurorinë për Ndjekjen e Krimit të Organizuar, dhe treguan rezultate impulsive në vlerësimin praktik të lëndës së armatimit. Studentët e Drejtësisë vizituan Gjykatën Administrative dhe Kuvendin e RMV-së, kur studentët e Punës Sociale realizuan vizita në Entin për Rehabilitim të Fëmijëve dhe në institucionet e mbrojtjes sociale. Studentët e Psikologjisë kryen mbi 20 vizita në shkolla fillore në Shkup dhe Kumanovë.

Trajnimi tregues me Deutsche Welle për studentët e Medive dhe Komunikimit Ndërkulturor, me fokus në gazetarinë mobile dhe luftën kundër dezinformimit, përbën një shembull konkret të lidhjes së arsimit me industrinë. Po ashtu, debati mbi ndikimin e huaj dhe sigurinë digjitale tregon që UNT po integron edukim kritik medial në jetën akademike, një ndërhyrje që ka peshë të veçantë në kontekstin e dezinformative që godasin rajonin.

Në fushën sportive, Omer Memeti, student i Fakultetit të Shkencave Sociale, u shpall Kampion Ballkanik në mundjë (kategoria U20, 92 kg) në Cluj të Rumani. Ekipi i UNT-së arriti pozitën e nënkampionit në Ligën NdërUniversitare, ndërsa studentët performuan me sukses në Universiadën e Nëntorit 2025 në Prishtinë. Këto arritje sportive, megjithëse shpesh të nënvlerësuara në diskursin akademik, kontribuojnë në ndërtimin e identitetit universitar dhe ndjenjës së përkatësisë.

6. Publikimet Akademike dhe Promovimet Librësh

Një tregues i rëndësishëm i maturimit të një universiteti është prodhimi i tij botimet. Gjatë këtij semestri, UNT regjistroi katër promovime të veçanta librash, secili me profil të ndryshëm. Rektori Fetaji promovoi dy tekste universitare, “Hyrje në Programim” dhe “Web Programimi”, që adresojnë një nevojë reale për literaturë teknike në gjuhën shqipe, një tregues mungese që ka qenë e pranishme prej kohësh në fushën e informatikës.

Prof. Dr. Aziz Pollozhani, ish-rektor i UNT-së, promovoi dy vepra dygjuhëshe mbi etikën shëndetësore, duke adresuar një fushë bashkëkohore që ndërthur shkencën me filozofinë morale. Prof. Dr. Sunaj Raimi prezantoi “Përsiatje postmoderniste në Facebook”, një titull që në vetvete sugjeron hibridizimin e mendimit kritik me median sociale, një zgjedhje tematike e guxueshme për kontekstin akademik vendas. Prof. Inor. Dr. Isak Idrizi promovoi dy vëllime në mekanikë inxhinierike (Statika dhe Dinamika), ndërsa studenta Melika Rustemi prezantoi përmbledhjen poetike “Në frymën e qetësisë”, një fakt që tregon se UNT po ushqen edhe krijimtarinë letëre përtej kërkimit shkencor.



Këto botime, marrë së bashku, pasqyrojnë një gamë të gjerë disiplinare: nga informatika dhe inxhinieria deri tek etika mjekësore, teoria postmoderne dhe poezia. Për një universitet me vetëm nëntë vjet operim, ky është një sinjal inkurajues, edhe pse volumi i përgjithshëm mbetet modest kur krahasohet me institucione më të vjetra.

7. Inovacioni, Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Transformimi Digjital

Ndoshta dimensionin më i freskët i aktivitetit të UNT-së gjatë këtij semestri lidhet me inovacionin e aplikuar dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Produkti “EcoScrub” (krem piling nga biombetjerinat e kafesë), i zhvilluar nga ekipi i Fakultetit të Shkencave Teknologjike, fitoi si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal në konkursin “Green Ideas 2025” dhe Balkan Green Ideas. Ky sukses i dyfishtë tregon se kapaciteti inovativ i UNT-së nuk është vetëm teorik, por ka dalë në arenën kompetitive.

Memorandumi me Avant Car për ndarjen e automjeteve elektrike (“Avant2Go”) përbën një rast studimi interesant për bashkëpunimin universitet–industri në fushën e mobilitetit të gjelbër. Ligjërata e mbajtur në UNT mbi këtë temë e kaloi kuadrin e zakonshëm akademik, duke e shëndruar universitetin në një hapësirë ku diskutohet inovacioni urban konkret. Bashkëpunimi me EKOFLUID për riciklimin e vajrave të përdorura shton një tjetër shtër në këtë angazhim ekologjik.

Në planin e transformimit digjital, prezantimi i Asistentes Virtuale “Nënë Tereza” (1 dhjetor 2025), një platformë inteligjence artificiale tregjuhëse (shqip, maqedonisht, anglisht), shënon një hap konkret drejt modernizimit të shërbimeve universitare. Kjo është një nga iniciativat e para të këtij lloji në universitetet publike të vendit, dhe merita vëmendje të veçantë si precedent. Pjesëmarrja në punëtorinë IVAP 2025 në Krakov (në kuadër të HEI2MARKET/EIT) dhe iniciativa IPPAN për qendrat e bashkëpunimit universitet–industri (USIMP) forcojnë këtë profil inovativ.

Punetoria për zhvillim të qëndrueshëm në kuadër të Fondit të Ballkanit Perëndimor, pjesëmarrja në EIT Food Challenge Labs 2025 dhe ligjërata klinike për sigurinë ushqimore me Appetit Group plotësojnë këtë tablo. UNT po ndërton një ekosistem ku qëndrueshmëria nuk është vetëm retorikë, por fusha konkrete veprimi.

8. Ngjarjet Kulturore, Komemorative dhe Angazhimi Shoqëror

UNT nuk e kufizon vetveten në një hapësirë stërrit akademike. Panel diskutimi në nderim të Ditës së Shenjtërimit të Nënë Terezës (3 shtator), Akademia Solemne për 22 Nëntorin (Ditën e Alfabetit të Gjuhës Shqipe), dhe Konferenca e 28 Nëntorit (Ditës së Flamurit) tregojnë një universitet që merr përsipër edhe bartën e memoriës kolektive. Këto ngjarje nuk janë vetëm ceremoniale; ato janë akte të pozicionimit identitar të një institucioni që mban emrin e një figurë universale si Nënë Tereza.

Ceremonia e 9-vjetorit të UNT-së (22 dhjetor) u kurorëzua me ndarjen e titullit “Doctor Honoris Causa” për Akademik Alajdin Abazin, një akt që i jep institucionit një peshe simbolike të rëndësishme. Ndarja e



Plaketës Jubilare të 80-vjetorit të Kryqit të Kuq për UNT-në (2 dhjetor), e shoqëruar me një panel diskutimi mbi praktikën humanitare, tregon që angazhimi shoqëror nuk është periferik në misionin e universitetit.

Punësoria në kuadër të Tetorit Rozë (mbi mirëqenien psikike si parandalim ndaj sëmundjeve të rrezikshme), shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Personave me Nevoja të Veçanta, dhe mbështetja e projektit për praktika riparuese e ndërmjetësimi tek të rinjtë forcojnë dimensionin social të UNT-së. Marrëveshja kolektive e sindikatës së UNT-së me Kuvendin e RMV-së, ndërkohë, siguron të drejta konkrete për të punësuarit akademikë dhe administrativë.

9. Vlerësime Përfundimtare dhe Rekomandime

Tabloja që del nga ky katërmujor është ajo e një universiteti në lëvizje të shpejtë, që po ndërton njëkohësisht në disa fronte: infrastrukturën e bashkëpunimit ndërkombëtar, prodhimin shkencor, jëtë studentore, inovacionin e aplikuar dhe praninë kulturore. Për një universitet me vetëm nëntë vjet jetë, ky është një ritëm ambicioz.

Në përfundim, semestri dimëror 2025 përbën dëshminë bindëse se UNT ka kaluar fazën e konsolidimit fillestar dhe po hyn në një fazë të re, ku sfida nuk është më të ekzistojë, por të ekzistojë me ndikim. Këtë tranzicion do ta përcaktojë aftësia e institucionit për të shëndruar sasinë e aktiviteteve në cilësi të matshme, memorandumet në projekte konkrete, dhe praninë ndërkombëtare në ndikim të qëndrueshem shkencor.



UNT DHE SH.M.Q.SH “ARSENI JOVKOV” NË SHKUP NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Shkup, 02.09.2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup dhe Shkolla e mesme ekonomike-juridike të qytetit të Shkupit “Arseni Jovkov” nënshkruan sot Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim forcimin e lidhjes ndërmjet arsimit të mesëm profesional dhe arsimit të lartë universitar.

Marrëveshja u nënshkrua nga rektori i UNT-së, Prof. Dr. Bekim Fetaji, dhe drejtori pranë Sh.M.Q.Sh “Arseni Jovkov”, z. Blerim Zekiri,

duke krijuar një platformë të re për zhvillimin e praktikave profesionale, shkëmbimin e përvojave arsimore dhe përgatitjen më cilësore të gjeneratave të reja për tregun e punës.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/14W2LSXHDKb/>

PANEL DISKUTIM NË NDERIM TË DITËS SË SHENJTËRIMIT TË NËNË TEREZËS



Shkup, 03.09.2025 - Në përkujtim të ditës së shenjtërimit të Gonxhe Bojaxhiut - Nënë Terezës, simbol i humanizmit dhe përkushtimit ndaj të tjerëve, Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup në bashkëorganizim me Institutin për Trashëgimi Kulturorë dhe Shpirtërorë të Shqiptarëve, organizoi panel diskutimin me temë: “NËNË TEREZA NGA SHKUPI NË ALTARIN E SHENJTËRISË”.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://shorturl.at/5NP5Q>

UNT DHE UNIVERSITETI “İSTANBUL MEDENIYET” NËN SHKRUAN MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Shkup, Shtator 2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, priti në një takim pune delegacionin e Universitetit “İstanbul Medeniyet” nga Turqia, të udhëhequr nga rektori i këtij universiteti, Prof. Dr. Gülfettin Çelik. Ky takim u zhvillua në frymën e bashkëpunimit akademik dhe shkencor dhe pasoi me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet dy institucioneve.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1SdVocLCoz/>

UNT HAP DYERT PËR STUDENTËT E RINJ NË AFATIN E DYTË TË REGJISTRIMEVE

Në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup vijon procesi i regjistrimit të kandidatëve potencialë në afatin e dytë për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha tetë fakultetet studimore, si universiteti i vetëm publik në kryeqytet në gjuhën amëtare.

Rektori i UNT-së, Prof. Dr. Bekim Fetaji, i shoqëruar nga kryetarja e Komisionit Universitar për Regjistrim për vitin akademik 2025/2026, Doc. Dr. Arta Xhelili, si dhe sekretari i përgjithshëm, Mr. Pishtar Lutfiu, vizituan njësitë akademike ku po zhvillohet procesi i aplikimit.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/18LaEQxeTT/>

REKTORI FETAJI TAKOHET ME KRYETAREN E ILPP, PRANVERA KASAMI



Shkup, 10.09.2025 - Rektori i Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, priti në një takim pune kryetaren e Institutit për Lidership dhe Politika Publike, znj. Pranvera Kasami.

Gjatë takimit, rektori Fetaji theksoi rëndësinë e bashkëpunimeve strategjike dhe projekteve të përbashkëta të Universitetit "Nënë Tereza" me organizata të ndryshme, veçanërisht ato joqeveritare, të cilat kontribuojnë në zhvillimin akademik dhe shoqëror.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/17JVCb4Aj2/>

TAKIM ONLINE MES UNT-SË DHE UNIVERSITETIT TË NORVEGJISË JUGLINDORE PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE



Shkup/Norvegji, 11.09.2025 - Rektori i Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, realizoi sot një takim online në platformën Google Meet me Prof. Inov. Dr. Glenn Agung Hole, ligjërues në Universitetin e Norvegjisë Juglindore.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1DaWvnLnB5/>

PUNËTORI NDËRUNIVERSITARE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM NË UNT

Shkup, shtator 2025 - Në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup u mbajt një punëtori në kuadër të projektit “Studentët për Zhvillim të Qëndrueshëm”, i cili financohet nga Fondi i Ballkanit Perëndimor.

Ky projekt ka për qëllim të fuqizojë studentët e rajonit të Ballkanit Perëndimor me njohuri dhe aftësi praktike mbi zhvillimin e qëndrueshëm. Përmes trajnimeve, punëtorive dhe aktiviteteve ndëruniversitare, ai synon të avancojë agjendën e gjelbër, efikasitetin energjetik, teknologjitë e gjelbra dhe praktikën e qëndrueshme në arsimin e lartë dhe shoqëri.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim:



<https://www.facebook.com/share/p/1FK6oR5RWv/>

REKTORI FETAJI PRITI DELEGACIONIN E UNOPS NË UNT

Shkup, 15.09.2025 - Në kabinetin e punës, rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, priti një delegacion nga Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Shërbime Projektuale, UNOPS, i kryesuar nga znj. Kalinka Gaber.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/18HNFLw3cp/>

TAKIM PUNE I REKTORIT FETAJI ME PËRFAQËSUESIN E AMBASADËS AMERIKANE, GAZMEND ILAZI



Shkup, Shtator 2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, priti në kabinetin e tij përgjegjës për programe arsimore njëherit koordinator e Programit Alumni pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup, z. Gazmend Ilazi.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1FuZj373VP/>

REKTORI FETAJI MIRËPRITI PROF. DR. SCHMITT NGA VJENA DHE DR. ZELEPOS NGA JANINA

Shkup, 16.09.2025 - Sot, në kabinetin e tij të punës, rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, mirëpriti profesorin e njohur dhe historianin e shquar, Prof. Dr. Oliver Jens Schmitt nga Vjena, si dhe Dr. Ioannis Zelepos, ligjërues në Universitetin e Janinës.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1BvnxugPc8/>

INOVACIONI I FAKULTETIT TEKNOLOGJIK NGA UNT SHËNON FITORE NË “GREEN IDEAS 2025”

Shkup, 22.09.2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup ka kënaqësinë të njoftojë se ideja “Krem piling nga biombeturinat e kafesë - EcoScrub” është shpallur fituese në kategorinë e ideve embrionale në konkursin kombëtar “Green Ideas 2025”, ku konkuruan gjithsej 39 ide inovative.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1DVCCgdUkC/>

UNT MBËSHTET FUQIZIMIN E TË RINJVE PËRMES DIALOGUT DHE NDËRMJETËSIMIT

Shkup, shtator 2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup ka kënaqësinë të njoftojë mbështetjen e plotë të projektit “Promovimi i Praktikave Riparuese dhe Ndërmjetësimit tek të Rinjtë”, duke vënë në dispozicion hapësirat e tij universitare dhe duke inkurajuar studentët të bëhen pjesë aktive e këtij programi me rëndësi.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1H42KE9Vmy/>

SEMINAR PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE NË UNT

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup organizon më 29 deri më 30.09.2025 Seminarin për Ndërtimin e Kapaciteteve Institucionale.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1bAQ4smgZ8/>

WEB OF SCIENCE - MJET STRATEGJIK PËR CILËSINË SHKENCORE NË UNIVERSITETE

Shkup, 25.09.2025 - Kryetarja e senatit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Olivera Petrovska, dhe prorektori për Shkencë, Prof. Dr. Zoran Gacovski, morën pjesë në seminarin e organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me temë “Web of Science - Avancimi i punës shkencore dhe kërkimore në universitetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1S1rMSfp9f/>



MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM AKADEMIK NDËRMJET UNIVERSITETIT TË SHKODRËS DHE UNIVERSITETIT “NËNË TEREZA” NË SHKUP



Shqipëri, 25.09.2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup dhe Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në Shqipëri kanë nënshkruar një marrëveshje për bashkëpunim akademik, e cila synon të fuqizojë shkëmbimet dhe aktivitetet e përbashkëta mes profesorëve, studentëve dhe stafit të të dy institucioneve.

Rектори UNT-së, Prof. Dr. Bekim Fetaji, dhe rektori i Universitetit të Shkodrës, Prof. Dr. Tonin Gjuraraj

nënshkruan këtë marrëveshje pa afat kohor, duke theksuar angazhimin e përbashkët për zhvillimin e arsimit dhe kërkimeve shkencore në rajon.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1BzW81rDR5/>

UNT NË TAKIMIN JUBILAR XX VJETOR TË DIASPORËS SHKENCORE NË SHQIPËRI

Tiranë, 26.09.2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, mori pjesë në Takimin jubilar XX vjetor ndërkombëtar me temë: “Kontributi i diasporës shkencore për integrimin në hapësirën evropiane të kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë mbarëkombëtar”, i organizuar nga Instituti Alb-Shkenca, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1DVGY4dNu5/>



SEMINARI PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE NË UNT

Profesorë nga SHBA, Mbretëria e Bashkuar dhe rajoni në seminarin e UNT-së

Shkup, 29.09.2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup nisi me sukses seminarin dyditor për Ndërtimin e Kapaciteteve Institucionale, një aktivitet akademik i rëndësishëm me pjesëmarrjen e profesorëve dhe ekspertëve të njohur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar dhe rajoni, si dhe me angazhimin e stafit të plotë akademik e administrativ të UNT-së.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1CTLj8Fjg8/>

FILLON VITI AKADEMIK 2025/2026 NË UNIVERSITETIN “NËNË TEREZA” NË SHKUP

1040 regjistrime, UNT rrit potencialin akademik dhe konfirmon misionin e tij edukativ

Shkup, 01.10.2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup shënoi sot fillimin e vitit të ri akademik



2025/2026 me një ceremoni solemne para kampusit universitar, duke mirëpritur gjeneratën e dhjetë të studentëve. Ky vit shënon një arritje të veçantë për institucionin, pasi për herë të parë numri i studentëve të regjistruar ka arritur në 1040, duke e pozicionuar UNT-në si një ndër universitetet me ritmin më të lartë të rritjes në vend.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1CADRz4BX3/>



REKTORI FETAJI PRITI NË TAKIM PUNE DREJTORIN E KLINIKËS UNIVERSITARE PËR SËMUNDJE TË FËMIJËVE, DR. REXHEP MEMEDI



Shkup, tetor 2025 – Në ambientet e kabinetit të punës, Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, priti në një takim pune drejtorin e Klinikës Universitare për Sëmundje të Fëmijëve në Shkup, Dr. spec. Rexhep Memedi.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/14UmWjk8AAU/>

REKTORI FETAJI NË TAKIM ME PËRFAQËSUES TË AMBASADËS SË ZVICRËS

Shkup, 02.10.2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, së bashku me prorektoren për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Prof. Inor. Dr. Dituriye Ismaili, zhvilluan një takim pune në Ambasadën e Zvicrës në RMV.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1BLwu3f4v7/>

REKTORI FETAJI I THIRUR NGA AMBASADA GJERMANE ME RASTIN E DITËS SË BASHKIMIT TË GJERMANISË



Shkup, 03.10.2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, me ftesë të Ambasadores së Republikës Federale të Gjermanisë në Shkup, Shkëlqesia e Saj, znj. Petra Drexler, mori pjesë në pritjen solemne të organizuar me rastin e Ditës së Bashkimit të Gjermanisë, e cila u mbajt në hollin e Hotelit Aleksandar Palace.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/19tMeqsBJL/>

REKTORI FETAJI MIRËPRET AMBASADOREN E JAPONISË, SH.S. SETSUKO KAWAHARA

Shkup, 06.10.2025 - Sot, në kabinetin e tij të punës, rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, mirëpriti ambasadoren e Japonisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Shkëlqesinë e Saj, znj. Setsuko Kawahara, me të cilën zhvilloi një takim miqësor dhe frytdhënës.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1HAot7c3QP/>

REKTORI FETAJI NË TAKIM ZYRTAR ME REKTORIN PROF. DR. LÛTFI SUNAR

Shkup, Tetor 2025 - Në kuadër të bashkëpunimit ndëruniversitar dhe forcimit të lidhjeve akademike, u realizua një vizitë zyrtare e përfaqësuesve të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, të kryesuar nga rektori, Prof. Dr. Bekim Fetaji, së bashku me prorektorët, Prof. Inor. Dr. Diturije Ismaili dhe Prof. Inor. Dr. Fati Iseni, si dhe Mr. Alajdin Memedi.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim:

<https://www.facebook.com/share/p/1EDGv2QJTg/>



NËNSHKRUHET MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NDËRMJET UNIVERSITETIT “NËNË TEREZA” NË SHKUP DHE KOMPANISË “AVANT CAR”

Shkup, 08.10.2025 - Në hapësirat e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, të përfaqësuar nga rektori, Prof. Dr. Bekim Fetaji, dhe kompanisë për shërbime mobile Avant Car, të përfaqësuar nga drejtori Martin Milevski.

Ky memorandum, i nënshkruar në kuadër të projektit për ndarjen e automjeteve elektrike “Avant2Go”, parasheh zhvillimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim promovimin e mobilitetit të gjelbër dhe zgjidhjeve të qëndrueshme për transportin urban në qytetin e Shkupit.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/17yVAzNhxQ/>

EKIPI I FAKULTETIT TË SHKENCAVE TEKNOLOGJIKE NGA UNT FITUES EDHE NË GARAT RAJONALE TË "GREEN IDEAS 2025"

Shkup, Tetor 2025 - Në edicionin e sivjetshëm të Balkan Green Ideas 2025, ekipi i Fakultetit të



Shkencave Teknologjik e përfaqësoi Maqedoninë e Veriut dhe u shpall fitues rajonal në Balkan Green Ideas 2025 me idenë inovative EcoScrub, një krem natyral i krijuar nga mbetjet e kafesë.

Gara e sivjetshme, e cila zgjati pesë ditë dhe u mbajt në Ohër, mbledhi 20 ide të gjelbra nga gjashtë shtete të rajonit. Mes konkurrencës së fortë, ECoScrub u dallua për qasjen e saj kreative dhe të qëndrueshme ndaj mbetjeve organike. Fituesit u zgjodhën nga një juri profesionale

ndërkombëtare me përfaqësues nga Belgjika, Austria ,Greqia dhe Bullgaria.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1RS7imzBwL/>

STUDENTI I UNT-SË, OMER MEMETI, SHPALLET KAMPION BALLKANIK NË MUNDJE

Në Kampionatin Ballkanik të Mundjes, i cili u mbajt në Cluj, Rumani, studenti i Fakultetit të Shkencave Sociale, nga programi studimor Sport dhe Shkenca Sportive, Omer Memeti, arriti një sukses të jashtëzakonshëm duke u shpallur Kampion Ballkanik në sportin e mundjes, në kategorinë e moshave U20 dhe kategorinë e peshës 92 kg.

Omer Memeti është pjesë e Klubit të Mundjes “Liria” në Shkup dhe përfaqësues i reprezentacionit të Maqedonisë së Veriut, duke dëshmuar me performancën e tij nivel të lartë teknik, shpirt garues dhe profesionalizëm.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1HEtx685gq/>

REKTORI FETAJI NË VIZITË ZYRTARE NË UNIVERSITETIN E MARMARASË NË STAMBOLL

Turqi/Stamboll, 16.10.2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, zhvilloi një vizitë zyrtare në Universitetin e Marmarasë në Stamboll, ku u prit nga rektori i Universitetit të Marmarasë, Prof. Dr. Mehmet Emin Okur.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim:



<https://www.facebook.com/share/p/1CFbBCJzrG/>

INOVACION, KËRKIM DHE BASHKËPUNIM, UNT PJESË E TAKIMIT TË “HEI2MARKET” NË STAMBOLL

Stamboll, 16-17.10.2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, i shoqëruar nga Prof. Dr. Zoran Trifunov, Prof. Dr. Monika Lutovska dhe Prof. Dr. Vladimir Kitanovski, pjesë e takimit dy ditorë ndërkombëtar të projektit “HEI2MARKET”, i cili po

zhvillohet në Universitetin e Marmarasë në Stamboll, nën organizimin e Qendrës për Kërkime dhe Zbatime në Nanoteknologji dhe Biomateriale (NBUAM).



Projekti “HEI2MARKET”, që realizohet në kuadër të EIT HEI Initiative, synon të forcojë kapacitetet inovative dhe ndërmarrëse të institucioneve të arsimit të lartë, përmes bashkëpunimit me sektorin e biznesit dhe industrisë, si dhe zhvillimit të strategjive të qëndrueshme për transferimin e dijes dhe inovacionit.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1HSXYuCpcB/>

UNT NËNSHKROI MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME KOMPANINË GJIGANTE “UNIPROMET” NGA ÇAÇAKU I SERBISË

Çaçak, Serbi, 20 tetor 2025 - Një delegacion i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, i udhëhequr nga rektori Prof. Dr. Bekim Fetaji, dhe i përbërë nga kryetarja e Senatit, Prof. Dr. Olivera Petrovska, si dhe profesorë, asistentë dhe shtatë studentë të Fakultetit të Shkencave Teknike, bashkë me Mr. Driton Zendeli, realizoi një vizitë zyrtare në kompaninë prestigjioze UNIPROMET në Çaçak të Serbisë, ku u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi strategjik ndërmjet dy institucioneve.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1HMpsf4s9i/>

KONFERENCA PËRMBYLLËSE E PROJEKTIT COUTURE NË UNIVERSITETIN EUROPIAN TË TIRANËS

Tiranë, 16.17.10.2025 - Në ambientet e Universitetit European të Tiranës u zhvillua Konferenca Përfundimtare e projektit COUTURE, e mbështetur nga programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian dhe e udhëhequr nga Kolegji Universum.

Në këtë ngjarje morën pjesë prorektorja e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Inor. Dr. Diturije Ismaili, dhe Doc. Mr. Genta Spahiu Mirzo, përfaqësuese të institucionit tonë. Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup kontribuoi në projekt me ekspertizën akademike të stafit, duke ofruar trajnime për stafin dhe studentët e institucioneve partnere.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1EQGSdyzka/>

STUDENTËT E MEDIAVE DHE KOMUNIKIMIT NDËRKULTUROR NË TRAJNIM TREDITOR ME PRESTIGJIOZEN DEUTSCHE WELLE

Shkup, tetor 2025 - Studentët e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, nga Fakulteti i Shkencave Sociale të programit studimor Media dhe Komunikim Ndërkulturor, realizuan një trajnim profesional treditor me përfaqësues të televizionit gjerman me shtrirje globale, Deutsche Welle.

Trajnimi me titull: "E VËRTETA NË XHEPIN TËND - ZOTËRIMI I GAZETARISË MOBILE DHE LUFTA KUNDËR DEZINFORMACIONIT", pati për qëllim të ofrojë një guidë profesionale teoriko-praktike rreth realizimit të storjeve të dedikuara për media sociale, si dhe aftësimin e studentëve në detektimin e çrregullimit informativ dhe edukimit digjital në epokën e Inteligjencës Artificiale.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1KeyYP2Y8F/>

TAKIM MIQËSOR ME DREJTORËT E SHKOLLAVE TË MESME, MIRËNJOHJE PËR BASHKËPUNIMIN NË AVANCIMIN E ARSIMIT

Shkup, 28.10.2025 - Sot, në ambientet e senatit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, rektori Prof. Dr. Bekim Fetaji priti në një takim pune drejtorët e shkollave të mesme nga qytete të ndryshme të vendit, në kuadër të aktivitetit “Kafja e mëngjesit me rektorin”.

Takimi kishte për qëllim vlerësimin e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet arsimit të mesëm dhe atij universitar, si dhe forcimin e partneriteteve për përgatitjen e kuadrove të rinj profesional.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/17XssrLK2W/>

TAKIM I FRYTSHËM NË UNT ME FONDACIONIN “AXIS”, BASHKËPUNIM PËR ZHVILLIM ARSIMOR DHE KULTUROR

UNT dhe Fondacioni "AXIS" fuqizojnë bashkëpunimin për projekte arsimore, kulturore dhe ndërkulturore

Shkup, 29.10.2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, mirëpriti në takim pune përfaqësuesit e Fondacionit për Zhvillim dhe Qytetërim “AXIS”, të udhëhequr nga drejtori ekzekutiv z. Rufat Sherifi, së bashku me Dr. Kujtim Kasami, kryetar i Qendrës për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim Institucional, dhe Mr. Milazim Mustafi.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1aRtPdRzC8/>

TAKIM NË UNT ME DELEGACION NGA QEVERIA TURKE

Fokus në bashkëpunim akademik dhe fuqizimin e grave në shkencë

Shkup, tetor 2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, në bashkëpunim me Rrjetin e Grave në Shkencë, mirëpriti një delegacion nga qeveria turke, të kryesuar nga deputetja znj. Rukiye Toy.

Delegacionin u mirëpriti nga prorektorja për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Prof. Inor. Dr. Diturije Ismaili, e shoqëruar nga dekanja e Fakultetit të Shkencave Sociale, Doc. Dr. Arta Xhelili, dhe Doc. Dr. Elisabeta Bajrami Ollogu.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1GF56nnDvV/>

TEKNOLOGJI, INOVACION DHE QËNDRUESHMËRI, KOMPANIA “AVANTCAR” PREZANTON NË UNT

Shkup, 30.10.2025 - Në kuadër të aktiviteteve për bashkëpunim me kompani ndërkombëtare të inovacionit dhe zhvillimit teknologjik, në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup u realizua ligjërata me temë “Ndarja e automjeteve elektrike, drejt një mobiliteti të qëndrueshëm”, e mbajtur nga kompania Avantcar, e cila është e njohur në rajon për zgjidhjet e saj bashkëkohore në fushën e transportit të gjelbër.

Ligjërata u mbajt nga menaxheri kryesor i klientëve nga kompania AVANTCAR në Republikën e Maqedonisë së Veriut, z. Darko Stefanovski, i cili prezantoi konceptin inovativ të ndarjes së automjeteve elektrike për përdorim të përbashkët, si një model modern i lëvizshmërisë urbane që ndihmon në uljen e ndotjes, zhurmës dhe ngarkesës në komunikacion.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1DXJPn8uaQ/>

PUNËTORI FRYMËZUESE NË UNT NË KUADËR TË TETORIT ROZË

30.10.2025 - Në kuadër të Tetorit Rozë dhe aktiviteteve për sensibilizimin ndaj kancerit të gjirit dhe sëmundjeve të tjera të rrezikshme, Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, në bashkëpunim me psikoterapisten Mr. Alije Alimi, realizuan me sukses punëtorinë frymëzuese me temë: “Emocionet dhe trupi: mirëqenia psikike si mburojë parandaluese ndaj sëmundjeve të rrezikshme”.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1HZWunXsDQ/>

KONFERENCË NDËRKOMBËTARE NË UNT: BASHKËPUNIM SHKENCOR NË FUSHËN E GJEODEZISË DHE KARTOGRAFISË

Shkup, 31.10.2025 - Në kampusin e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup u mbajt konferenca ndërkombëtare me temë “Towards a State Plane Coordinate System: Scientific Approaches and Practical Challenges”, ku UNT ishte nikoqir dhe bashkëorganizator së bashku me Institutin e Gjeoshkencave (South-East European Research Institute on Geo Sciences), nën ombrellën e organizatës botërore për gjeodezi FIG (International Federation of Surveyors) dhe organizatës botërore për hartografi ICA (International Cartographic Association), si dhe në bashkëpunim me organizatën evropiane të gjeodetëve EGoS (European Group of Surveyors), Asociacionin Bullgar të Hartografisë, Shoqatën Kroate të Hartografisë, Shoqatën e Gjeodetëve të Kosovës dhe Odën e Gjeodetëve të Maqedonisë së Veriut.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1LTsp1JgdT/>

UNT DHE ORGANIZATA EVROPIANE E GJEODETËVE NËNSHKRUAN MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Shkup, 31.10.2025 - Në prani të përfaqësuesve akademik dhe ndërkombëtarë, rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji dhe drejtori nga Organizata Evropiane e Gjeodetëve EGoS (European Group of Surveyors) me seli në Romë të Italisë, z. Nikolaos Zacharias nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit, duke vendosur bazat për një bashkëpunim të qëndrueshëm në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit të programeve arsimore.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/14X6PdAEqFP/>

NËNSHKRUHET MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NDËRMJET UNT-SË DHE GEO SENSORS – ALBMATRIX NGA TIRANA

Shkup, nëntor 2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup dhe kompania GeoSensors - AlbMatrix me seli në Tiranë të Republikës së Shqipërisë, nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit, duke vendosur bazat për një bashkëpunim të qëndrueshëm në fushën e kërkimit shkencor, programeve arsimore dhe projekteve inovative teknologjike.

Memorandumi u nënshkrua nga rektori i UNT-së, Prof. Dr. Bekim Fetaji, dhe drejtori i përgjithshëm i GeoSensors - AlbMatrix, z. Emiliano Qose, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit akademik dhe zhvillimit të projekteve teknologjike në rajon.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1DJF4BjoGn/>

UNT MIRËPRET STUDENTËT E RINJ TË MASTER STUDIMEVE

Rrektori Fetaji së bashku me stafin akademik uroi studentët për zgjedhjen e tyre dhe theksoi rëndësinë e studimeve pasuniversitare për zhvillimin e tyre profesional dhe akademik

Shkup, nëntor 2025 - Në ambientet e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup u mirëpritën studentët e rinj të ciklit të dytë të studimeve me rastin e fillimit të semestrit dimëror për vitin akademik 2025/2026.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/17wskMebSf/>

PROMOVOHET LIBRI “PËRSIATJE POSTMODERNISTE NË FACEBOOK” I PROF. DR. SUNAJ RAIMIT



Shkup, nëntor 2025 - Në ambientet e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, u mbajt ceremonia promovuese e librit më të ri të autorit dhe profesorit të UNT-së, Prof. Dr. Sunaj Raimi, me titull “Përsiatje postmoderniste në Facebook”. Ngjarja u zhvillua përpara një auditori të gjerë me pjesëmarrje nga përfaqësues akademikë, studiues, studentëve dhe dashamirë të librit.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1FQmesFEC8/>

REKTORI FETAJI PRITI NË TAKIM PËRFAQËSUES TË BANKËS BOTËRORE

Shkup, nëntor 2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, i shoqëruar nga prorektorja për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Prof. Inor. Dr. Diturije Ismaili, mirëpritën sot në kabinetin e tij përfaqësues nga Banka Botërore të udhëhequr nga znj. Bojana Naceva, specialiste e Lartë për Arsim dhe Udhëheqëse e Ekipit të Detyrës në Bankën Botërore.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/187iiUBYDk/>

REKTORI FETAJI PRITI NË TAKIM PUNE PËRFAQËSUES NGA KOMPANIA EVN MAQEDONI



Shkup, nëntor 2025 - Në shenjë të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet arsimit të lartë dhe sektorit privat, rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, mirëpriti në takim pune përfaqësuesit e kompanisë EVN Maqedoni, z. Vigan Ademi dhe z. Fisnik Oseku, për të diskutuar perspektivat e zhvillimit të përbashkët.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/18JnQvCG5i/>

TAKIM MES UNT-SË DHE UNIVERSITETIT TË NORVEGJISË JUGLINDORE PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE

Shkup/Norvegji, 05.11.2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, realizoi sot një takim me Prof. Inor. Dr. Glenn Agung Hole, ligjërues në Universitetin e Norvegjisë Juglindore.

Në takim morën pjesë edhe prorektorët Prof. Inor. Dr. Diturije Ismaili, Prof. Inor. Dr. Fati Iseni, sekretari i përgjithshëm Mr. Pishtar Lutfiu, anëtar i Senatit Prof. Inor. Dr. Argëtim Saliu si dhe Dr. Sc. Arbnor Rushiti.

Rektori Fetaji njoftoi Prof. Dr. Hole, z. Blerim Gjoni dhe z. Bujar Shala mbi zhvillimet e fundit në UNT, përfshirë avancimin akademik e shkencor, bashkëpunimet e shumanshme me institucione të brendshme e ndërkombëtare, si dhe sfidat e përbashkëta që i presin universitetet sot.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1DUAcBfuJZ/>



LIGJËRATË FRYMËZUESE NË UNT PËR INOVACIONIN DHE ZHVILLIMIN EKONOMIK NË KONTEKST GLOBAL NGA PROF. DR. GLENN A. HOLE



Shkup, 05.11.2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup pati nderin të mirëpresë para studentëve dhe stafit akademik një ligjërata të hapur me temën: “Sipërmarrja, Inovacioni dhe Rritja: Stabiliteti dhe Mirëqenia në një Botë në Ndryshim”, të zhvilluar nga Prof. Dr. Glenn Agung Hole, profesor dhe ekspert ndërkombëtar nga Norvegjia.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/16zGuEATah/>

FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNOLOGJIKE NË NGJARJEN ‘EIT FOOD CHALLENGE LABS 2025’

Në kuadër të ‘EIT Food Challenge Labs 2025’ të mbajtur në Shkup, mori pjesë një ekip përfaqësuesish nga Fakulteti i Shkencave Teknologjike të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, i përbërë nga staf akademik dhe studentë.

Gjatë kësaj ngjarjeje treditore kushtuar inovacionit në ushqim, pjesëmarrësit patën mundësinë të zhvillojnë ide dhe prototipe për produkte funksionale dhe të qëndrueshme, duke integruar kreativitetin me njohuritë shkencore.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1DB3ig648B/>

REKTORI FETAJI U MIRËPRIT NË NJË TAKIM PUNE NGA KRYETARI I KUVENDIT,
AFRIM GASHI



Shkup, nëntor 2025 - Në ambientet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, së bashku me kryetarin e Sindikatës së UNT-së, Prof. Dr. Avni Avdiu, realizuan një takim pune me kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Afrim Gashi.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/16eZrbK4or/>

REKTORI FETAJI PRITI NË TAKIM PUNE KOORDINATOREN REZIDENTE TË OKB-së,
ZNJ. RITA COLUMBIA

Shkup, 10.11.2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, priti në një takim pune koordinatoren Rezidente të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) në Maqedoninë e Veriut, znj. Rita Columbia.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/17SsdF4zQG/>

KONTRIBUT NË LITERATURËN SHKENCORE SHQIPE, DY LIBRAT E REKTORIT FETAJI PASUROJNË FUSHËN E INFORMATIKËS

Librat “Hyrje në Programim” dhe “Web Programimi” shërbejnë si ura midis teorisë dhe praktikës për studentët e informatikës nga Prof. Dr. Bekim Fetaji

Shkup, 11.11.2025 - Në një atmosferë akademike dhe festive, në ambientet e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, përpara një audience të përbërë nga staf akademik, administrativ dhe studentë, u zhvillua ceremonia e promovimit të dy librave universitarë të autorit, njëherësh rektor i universitetit, Prof. Dr. Bekim Fetaji, me titujt: “Hyrje në Programim” dhe “Web Programimi”.

Këto dy botime paraqesin një kontribut të rëndësishëm në literaturën teknike në gjuhën shqipe, duke ofruar bazë të fortë teorike dhe qasje praktike për studentët e fushës së informatikës.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1GCrVbZkrw/>

LIGJËRATË E HAPUR INSPIRUESE NGA REKTORI I UNIVERSITETIT “KADRI ZEKA”, PROF. INOR. DR. ARTAN DËRMAKU NË UNT



Shkup, nëntor 2025 - Në kuadër të bashkëpunimit akademik ndëruniversitar, në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup u realizua me sukses ligjërata e hapur nga rektori i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, Prof. Inor. Dr. Artan Dërmaku, në cilësinë e Profesorit Vizitues.

Ligjërata me temë: “Nga problemet e kënaqshmërisë së kufizuar (CSP) te inteligenca artificiale moderne, hipergratë, optimizimi dhe prirjet e reja në shkencat kompjuterike”, shënoi një ngjarje të rëndësishme për studentët e Fakultetit të Shkencave Informatike dhe për të gjithë të pranishmit, duke sjellë një qasje të thelluar mbi zhvillimet bashkëkohore në fushën e inteligjencës artificiale dhe aplikimeve të saj.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1JePYRhZpA/>

FORCIM I BASHKËPUNIMIT AKADEMIK DHE KËRKIMOR NDËRMJET UNT DHE UNIVERSITETIT “SHËN KLIMENT OHRIDSKI”

Manastir, 13.11.2025 - Delegacion i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, i kryesuar nga rektori, Prof. Dr. Bekim Fetaji, realizoi një vizitë pune në Universitetin “Shën Kliment Ohridski” në Manastir, i mirëpritur nga rektori, Prof. Dr. Igor Nedelkovski, dhe përfaqësues të udhëheqësisë akademike.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/18CYKmfHkJ/>

REKTORI I UNT-SË, PROF. DR. BEKIM FETAJI, FOLËS KRYESOR NË KONFERENCËN E 8-TË BOTËRORE PËR TË DHËNAT E MËDHA DHE INFORMATIKËN INTELIGJENTE

Shkup/Turqi, 14.11.2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, mori pjesë si Folës Kryesor (Keynote Speaker) në Konferencën e 8-të Botërore mbi “TË DHËNAT E MËDHA DHE INFORMATIKËN INTELIGJENTE”, një nga ngjarjet më të rëndësishme shkencore në fushën e teknologjisë së informacionit.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/19r2D4BFCf/>

REKTORI FETAJI NË DEBATIN PËR STRATEGJINË E RE TË ARSIMIT TË LARTË 2026-2032



Shkup, nëntor 2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, mori pjesë në seancën e evaluimit të propozim-strategjisë për Arsimin e Lartë 2026–2032, proces që synon definimin e drejtimit të zhvillimit të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitet në vijim.

Në këtë takim u zhvilluan diskutime të thelluara mbi çështje kyçe si, zhvillimi i arsimit, hulumtimit dhe inovacionit, resurset njerëzore dhe nevoja për ngritje të

kapaciteteve akademike, infrastruktura arsimore, modeli i financimit të arsimit të lartë, projektet ndërkombëtare si mekanizëm i rëndësishëm për transferimin e dijes në ekonomi dhe komunitet.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1BYrQUF431/>

STUDENTËT E UNT-SË ME PUNIM INOVATIV NË KONFERENCË NDËRKOMBËTARE NË NOVI SAD

Studentët e Fakultetit të Shkencave Teknologjike, Jehona Zeqiri, Anesa Behluli, Sabile Rustemi, Xhejlan Ramadanovski, Sara Haliti dhe Ermira Bafqari, përfaqësuan me sukses Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup në konferencën për studentët e Bujqësisë dhe Mjekësisë Veterinare, me pjesëmarrje ndërkombëtare, e cila u mbajt më 14 nëntor 2025 në Universitetin e “Novi Sad” të Serbisë.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1AbfHCo2uF/>

PROMOVIMI I SUKSESSHËM I LIBRIT “NË FRYMËN E QETËSISË” NGA MELIKA RUSTEMI NË UNT



Shkup, 18.11.2025 - Fakulteti i Shkencave Humane në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup realizoi me sukses promovimin e përmbledhjes poetike “Në frymën e qetësisë”, të autores Melika Rustemi, studente në vitin e tretë të Programit të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, aktiviteti u realizua në prani të stafit akademik, studentëve dhe dashamirëve të letërsisë.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/14VoTyLtrNW/>

STUDENTËT E FAKULTETIT EKONOMIK TË UNT-SË, REALIZUAN VIZITË STUDIMORE NË INSTITUTIN E KONTABILISTËVE

Studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup realizuan një vizitë studimore në Institutin e Kontabilistëve dhe Kontabilistëve të Autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vizita u realizua nën udhëheqjen e. Prof. Inor. Dr. Bukurie Imeri Jusufi, së bashku me Prof. Inor. Dr. Teuta Jusufi Zenku dhe Mr. Sara Muça.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/18Bzo6nrpR/>

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE PËR MIGRACIONIN NË UNT MBLEDH MBI 50 STUDIUES

Edicioni i 9-të i konferencës trajtoi sfidat bashkëkohore të migracionit, qeverisjes dhe kohezionit social



njëkohësisht me pjesëmarrje online përmes platformës Google Meet.

Shkup, 20.11.2025 - Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup organizoi edicionin e 9-të të Konferencës Ndërkombëtare për Migracionin, një ngjarje me rëndësi të veçantë shkencore, e cila mbledhi mbi pesëdhjetë studiues, ekspertë, politikëbërës dhe përfaqësues institucionalë nga vendi, rajoni dhe nga disa vende të Azisë. Konferenca u zhvillua me prezencë fizike dhe

Këtë vit, konferenca u karakterizua nga pjesëmarrje e gjerë akademike dhe një program i strukturuar në tre sesione shkencore, përfshirë edhe sesionin online. Nga mbi 50 aplikime, u aprovuan 36 punime shkencore për prezantim. Qëllimi kryesor i konferencës ishte adresimi i dinamikave bashkëkohore të migracionit global, transformimeve socio-ekonomike dhe sfidave të qeverisjes në kontekst ndërkombëtar.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1CRUkGUPbt/>



UNT SHËNOI 22 NËNTORIN - DITËN E ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE ME AKADEMI SOLEMNE

Shkup, 20.11.2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup në bashkëpunim me Agjencinë e



Zbatimit të Gjuhës dhe Muzeun e Alfabetit në Manastir sot organizoi Akademi solemne me të cilën mes personalitetesh të profileve të ndryshme u fol për peshën e shumëanshme që kishte përfundimi i suksesshëm i punimeve të këtij kongresi historik.

Akademine solemne të organizuar nga Rektori i UNT-së, Prof.dr. Bekim Fetaji nikoqir dhe njëkohësisht ideator i Akademisë Solemne e nderuan me pjesëmarrjen e tyre z. Lulzim Aliu, zëvendës ministër i Arsimit dhe

Shkencës, z. Granit Osmani, drejtor i Agjencisë për zbatimin e Gjuhës Shqipe në Maqedoninë e Veriut, z. Aldo Kelmenti, diplomat nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në RMV, ndërsa fjalim për shënimin e 22 Nëntorit zhvilloi dekan i Fakultetit të Shkencave Humane Prof.dr. Mustafa Ibrahim.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/17zK86Qhew/>

VIZITË STUDIMORE E STUDENTËVE TË KRIMINALISTIKËS NGA UNT NË KAZERMËN “ILINDEN”

Shkup, nëntor 2025 - Studentët e programit studimor Kriminalistikë të Fakultetit Juridik pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, nga viti i dytë dhe të tretë studimor, realizuan një vizitë dhe trajnim praktik në Kazermën “Ilinden”, në kuadër të lëndëve Armatimi dhe Pajisjet, Trajnimi me Armë dhe Forenzika. Aktiviteti u zhvillua nën mikpritjen e Batalionit të Policisë Ushtarake dhe Batalionit Vëzhgues – Ranger, me organizim të shkëlqyer të nënoficerit Kire Simonovski.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1DFKr8Rtq/>



REKTORI FETAJI MIRËPRET NË TAKIM ZYRTAR ZV/MINISTRIN E ARSIMIT, LULZIM ALIU



Shkup, nëntor 2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, priti në një takim pune zëvendësministrin e Arsimit dhe Shkencës, z. Lulzim Aliu, për një diskutim të nivelit të lartë mbi çështje strategjike të arsimit të lartë.

Në takim u diskutua për zhvillimet akademike e shkencore në UNT, projektet strategjike në vijim dhe vizionin e Universitetit për forcimin e cilësisë së arsimit të lartë, modernizimin e proceseve dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitutional.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1CvcEmRpOH/>

UNT NËNKAMPION NË LIGËN NDËR UNIVERSITARE

Shkup, nëntor 2025 - Në organizim të Federatës së Sporteve Universitare të Maqedonisë së Veriut, studentët e drejtimit të Sportit dhe Shkencave Sportive nga Fakulteti i Shkencave Sociale të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup zhvilluan ndeshjen e fundit të sezonit në palestrën e Fakultetit të Kulturës Fizike, Sportit dhe Shëndetit pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1CKsG9UQJH/>



U NËNSHKRUA MEMORANDUMI TREPALËSH I BASHKËPUNITIT MES UNT-së, AZGj-së DHE MUZEUT TË ALFABETIT



Shkup, nëntor 2025 - Në kuadër të përkujtimit të Ditës së Alfabetit të Gjuhës Shqipe, Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Muzeu i Alfabetit në Manastir nënshkruan një Memorandum trepalësh bashkëpunimi, i cili shënon themelimin e një partneriteti të ri akademik, kulturor dhe kërkimor ndërmjet tri institucioneve kyçe të vendit.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/16v1YsR6Q9/>

UNT DHE EKOFLUID NË PARTNERITET PËR EDUKIM, KËRKIM DHE PRAKTIKA EKOLOGJIKE

Shkup, nëntor 2025 - Fakulteti i Shkencave Teknike pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, kryesuar nga dekani Prof. Inor. Dr. Neritan Turkeshi nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi me kompaninë EKOFLUID, udhëhequr nga z. Besnik Ademi, ndërmarrje e licencuar dhe e specializuar në riciklimin e vajrave të përdorura nga amvisëritë dhe automjetet. Ky memorandum shënon një hap të rëndësishëm në drejtim të forcimit të lidhjes ndërmjet arsimit të lartë, sektorit industrial dhe praktikave të qëndrueshme mjedisore.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1AAeSZDtcK/>

STUDENTËT E UNT-SË DEBATOJNË PËR NDIKIMIN E HUAJ DHE SIGURINË ONLINE

Shkup, nëntor 2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup zhvilloi një debat tematik me studentët, i fokusuar në çështjet e ndikimit të huaj, sigurisë digjitale dhe edukimit medial, në kuadër të aktiviteteve ndërgjegjëse për përdorimin e sigurt dhe kritik të hapësirës online.

Ngjarja, e titulluar “Të rinjtë në fokus: Ndikimi i huaj, mediat dhe siguria digjitale”, solli diskutime të vlefshme mbi sfidat që paraqesin dezinformatat, profilet anonime dhe burimet joadekuate të informacionit, të cilat ndikojnë në mënyrën se si të rinjtë formojnë perceptimet e tyre shoqërore dhe politike.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/17yCgiVFLn/>

UNT NË PUNËTORINË IVAP 2025 NË KRAKOV - PËRFAQËSIM DINJITOZ NË KUADËR TË PROJEKTIT HEI2MARKET

Poloni, 25.11.2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, së bashku me Prof. Inor. Dr. Vladimir Kitanovski, pjesëmarrës në punëtorinë ndërkombëtare IVAP Workshop 2025, e cila u mbajt në Krakov, Poloni, në kuadër të projektit HEI2MARKET, pjesë e iniciativës evropiane EIT Higher Education Initiative - Cohort 4.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/188Lw2uQUB/>

LIGJËRATË KLINIKE PËR SIGURINË USHQIMORE NË UNT

Shkup, nëntor 2025 – Studentët e Fakultetit të Shkencave Teknologjike, programi studimor Teknologji Ushqimore, pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, ndoqën një mësim klinik të mbajtur nga koordinatori dhe cilësisë dhe sigurisë ushqimore, Dr. Bashak Kyçykçakan Nikolovska, përfaqësuese e kompanisë për përpunimin e mishit Appetit Group - Shkup.



Qëllimi i këtij ligjërimi ishte të ofrojë njohje të drejtpërdrejtë me proceset reale të industrisë ushqimore, si dhe me sfidat që shoqërojnë prodhimin dhe kontrollin e cilësisë në këtë sektor.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1DKWQaYCtL/>

DITA E DYTË E IVAP 2025, SESIONE INTENSIVE DHE PUNËTORI PRAKTIKE NË KRAKOV

Poloni, 26.11.2025 - Rektori Prof. Dr. Bekim Fetaji dhe Doc. Dr. Vladimir Kitanovski vazhduan angazhimin e tyre aktiv në ditën e dytë të Punëtorisë IVAP 2025 në Krakov, në kuadër të projektit HEI2MARKET të Iniciativës së Arsimit të Lartë e EIT (Higher Education Initiative).

Dita e dytë përfshiu sesione intensive në ‘ICE Krakow Congress Center’, me punëtori praktike, diskutime tematike dhe shkëmbime profesionale të udhëhequra nga ekspertë të EIT. Fokus i veçantë iu kushtua zhvillimit të ekosistemeve të inovacionit, partneriteteve strategjike, qëndrueshmërisë dhe forcimit të kapaciteteve institucionale të orientuara drejt DeepTech.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/184XEkPmLR/>

PËRVOJË UNIKE PËR STUDENTËT E KRIMINALISTIKËS, MBI 3000 EKSPONATE NË NJË MUZE TË RRALLË



Shkup, nëntor 2025 - Studentët e programit studimor të Kriminalistikës pranë Fakultetit Juridik në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup, nën udhëheqjen e Prof. Dr. Naser Etemit, në kuadër të mësimit praktik vizituan Muzeun e Kriminalistikës.

Gjatë kësaj vizite, studentët patën mundësi të shohin mjete të ndryshme që janë përdorur për kryerjen e veprave penale, si dhe të dëgjojnë për praktika të ndryshme të përdorura në zbardhjen e tyre.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1DENLoXZt8/>

KONFERENCA SHKENCORE E 28 NËNTORIT MBAHET PËR TË DYTIN VIT RADHAZI NË UNT

Diskutim akademik mbi rolin, sfidat dhe perspektivat e shqiptarëve në RMV në kontekstin e zhvillimeve historike, shoqërore dhe politike

Shkup, 27.11.2025 - Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup, në bashkëpunim me Fondacionin për Zhvillim dhe Qytetërim AXIS dhe Qendrën për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim Institucional (QMBI), me rastin e Ditës së Flamurit, 28 Nëntorit, organizoi për të dytin vit radhazi Konferencën Shkencore me temë: "Shqiptarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 113 vjet pas Pavarësisë së Shqipërisë".



Ky aktivitet akademik mbledhi studiues, profesorë dhe përfaqësues të jetës publike, të cilët trajtuan aspekte kyçe historike, arsimore, politike, ekonomike dhe kulturore të shqiptarëve në hapësirën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim të thellimit të analizave shkencore dhe nxitjes së dialogut profesional.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1C6bWZyqEn/>

STUDENTËT E UNT-SË ME PERFORMANCË SHEMBULLORË NË PRISHTINË



Në Prishtinë, nën organizimin e Federatës së Sporteve Universitare të Kosovës dhe në atmosferën festive të ditëve të flamurit, u mbledhën universitete nga mbarë trojet shqiptare, duke sjellë energji, garë të shëndoshë, respekt dhe shumë shpirt sportiv për garat sportive të “Universiadës së Nëntorit 2025”.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1C1HEXvwHn/>

UNT PREZANTON ASISTENTEN VIRTUALE “NËNË TEREZA”

Mjet modern për qasje më të shpejtë në informacion dhe shërbime universitare

Shkup, 01.12.2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup sot prezantoi Asistenten Virtuale “Nënë Tereza”, një platformë inovative e inteligjencës artificiale që do të ofrojë ndihmë dhe orientim për studentët, stafin akademik dhe vizitorët në tre gjuhë: shqip, maqedonisht dhe anglisht.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/18LbDkVy3v/>

UNT NDEROHET ME PLAKETËN JUBILARE TË 80-VJETORIT TË KRYQIT TË KUQ

Ceremonia u shoqërua me Panel Diskutim ku në focus ishin solidariteti, edukimi qytetar dhe angazhimi i studentëve

Shkup, 02.12.2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, në bashkëorganizim me Kryqin e Kuq, realizoi me sukses ceremoninë e ndarjes së Plaketës Jubilare të 80-vjetorit të Kryqit të Kuq për UNT, si një vlerësim i rëndësishëm për kontributin e vazhdueshëm të Universitetit në promovimin e humanizmit, solidaritetit dhe edukimit qytetar. Pas ceremonisë vijoi edhe Panel Diskutimi me temën: “Përvojat dhe praktikat e mira si bazë për zhvillimin e strategjive të reja humanitare”.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/17xvYjgZxo/>

REKTORI FETAJI, ZHVILLOI NJË TAKIM PUNE ME DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË ORGANIZATËS “METAMORPHOSIS”, BARDHYL JASHARI

Shkup, Dhjetor 2025 - Në kabinetin e punës, rektori Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup mirëpriti në një takim pune drejtorin e organizatës “Metamorphosis”, z. Bardhyl Jashari, i njohur për kontributin e tij në forcimin e shoqërisë civile në vend.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1KRA98Unfs/>

REKTORI FETAJI, MIRËPRET PËRFAQËSUES NGA AMBASADA GJERMANE PËR TË DISKUTUAR MUNDËSITË E BASHKËPUNIMIT



Shkup, Dhjetor 2025 - Në ambientet e punës, rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, zhvilloi një takim zyrtar me përfaqësues diplomatikë nga Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë në Shkup: z. Kervin Maass, udhëheqës i Sektorit të Shtypit dhe Kulturës, si dhe znj. Susan Veselji Zuka, përfaqësuese e Shërbimit Gjerman për Shkëmbime Akademike në Maqedoninë e Veriut.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1C8tBJSpPT/>

UNT SHËNOI DITËN NDËRKOMBËTARE E PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Shkup, 03.12.2025 - Fakulteti i Shkencave Sociale pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, në bashkëorganizim me Qendrën “Dua Ylberin”, shënuan Ditën Ndërkombëtare të Personave me Nevoja të Veçanta përmes një Paneli Diskutimi, duke u drejtuar ndaj studentëve dhe stafit akademik.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1GUXX6EnwL/>

REKTORI I UNT-SË, PROF. DR. BEKIM FETAJI, REALIZON TAKIM PUNE ME KREUN E KOMUNËS ÇAIR, IZET MEXHITI



Shkup, 09.12.2025 - Delegacioni i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, i kryesuar nga rektori, Prof. Dr. Bekim Fetaji, u mirëprit në një takim zyrtar nga kryetari i Komunës Çair, z. Izet Mexhiti.

Rektori Fetaji, ishte i shoqëruar nga prorektori, Prof. Inor. Dr. Bujamin Bela, sekretari i përgjithshëm, Dr. Raim Jashari, dhe Mr. Alajdin Memedi.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/14V3NQqhJDD/>

VIZITË INSTITUCIONALE E STUDENTËVE TË PROGRAMIT STUDIMOR “PUNË DHE POLITIKË SOCIALE” NË ENTIN PËR REHABILITIM TË FËMIJËVE DHE TË RINJVE SHKUP

Shkup, Dhjetor 2025 - Studentët nga programi studimor "Punë Sociale dhe Politike Sociale" nga Fakulteti i Shkencave Sociale pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup realizuan me sukses vizitën institucionale të planifikuar për studentët e viteve të dyta dhe të katërta në Entin për Rehabilitim të Fëmijëve dhe të Rinjve në Shkup.



Kjo vizitë kishte për qëllim të ofronte për studentët përvojë të drejtpërdrejtë profesionale dhe njohuri praktike mbi institucionet dhe mekanizmat që trajtojnë çështje sociale, politikat publike dhe shërbimet komunitare.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1KACt7AJ6H/>



LIDHJA MIDIS TEORISË DHE PRAKTIKËS NË KRIMINALISTIKË NGA STUDENTËT E UNT-SË



Shkup Dhjetor 2025 - Studentët e Fakultetit Juridik, të programit studimor Kriminalistikë pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup nën udhëheqjen e Prof. Dr. Naser Etemi, vizituan Prokurorinë për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit të cilët u mirëpritën nga prokurori i kësaj prokurorie, z. Faton Idrizi, si dhe hetuesi Mr. Amir Dalipi.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1835XgC4DE/>

DY BOTIME TË REJA SHKENCORE NGA PROF.DR. AZIZ POLLOZHANI PASUROJNË LITERATURËN AKADEMIKE TË UNT-SË

Shkup, 11.12.2025 - Fakulteti i Shkencave Teknologjike pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup organizoi sot promovimin e dy librave të rëndësishëm, autor i të cilëve është ish-rektori i UNT-së, Prof. Dr. Aziz Pollozhani.

Dy veprat, të cilat trajtojnë tema të rëndësishme dhe bashkëkohore të etikës në fushën e shëndetësisë dhe teknologjisë, janë botuar në dy gjuhë: “Sfidat e reja në etikën shëndetësore” si dhe në gjuhën maqedone “Новите предизвици во медицинската етика”.

Në ceremoninë e promovimit morën pjesë personalitete akademike, profesorë, studentë dhe recensentë të veprave, të cilët theksuan rëndësinë e këtyre botimeve për zhvillimin e mendimit bashkëkohor etik dhe për avancimin e praktikave të përgjegjshme në shkencë dhe shoqëri.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1HWFJYvp4T/>

FILLOI PUNIMET KONGRESI DHE KONFERENCA NDËRKOMBËTARE DYDITORE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM “TSD 2025” NË UNT



Shkup, 15.12.2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup përmbylli me sukses ditën e parë të punimeve të Kongresit të III-të dhe Konferencës Ndërkombëtare për Zhvillim të Qëndrueshëm “TSD 2025”, e cila po zhvillohet sot dhe nesër në ambientet e Universitetit.

Në këtë konferencë, të organizuar nën patronazhin e rektorit të UNT-së, Prof. Dr. Bekim Fetaji, morën pjesë akademikë, studiues, ekspertë dhe përfaqësues institucionalë nga vende të ndryshme, të cilët diskutuan mbi çështje aktuale që lidhen me zhvillimin

e qëndrueshëm, inovacionin shkencor, teknologjinë dhe sfidat globale të së ardhmes.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1CH6NcBFQt/>

SINDIKATA E UNT-SË FIRMOS MARRËVESHJEN KOLEKTIVE ME KUVENDIN E RMV-SË

Shkup, 17.12. 2025 - Sot, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryetari i Sindikatës së Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Inor. Dr. Avni Avdiu, u mirëprit nga kryetari i Kuvendit të RMV-së, z. Afrim Gashi, ku u nënshkrua Marrëveshja Kolektive e Sindikatave Universitare.

Marrëveshja Kolektive avancoon dhe garanton të drejtat, përfitimet dhe privilegjet e të punësuarve të universiteteve publike, në kompetencë të themeluesit të tyre, Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1DG64d6Mwj/>



UNT FORCON EKOSISTEMIN E INOVACIONIT PËRMES INICIATIVËS IPPAN



Shkup, 18.12.2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup po ndërmerr hapa domethënës për forcimin e kapaciteteve institucionale në fushën e inovacionit dhe bashkëpunimit me industrinë. Rektori i UNT-së, Prof. Dr. Bekim Fetaji, së bashku me prorektorët, Prof. Inor. Dr. Sani Demiri, Prof. Inor. Dr. Bujamin Bela si dhe Prof. Dr. Ahu Altinkut Uncuoglu nga Universiteti i Marmarasë, zhvilluan një takim online me ekipin menaxhues të Platformës së Qendrave të Bashkëpunimit Universitet - Industri (USIMP).

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1BNCe2pRgz/>

VIZITË INSTITUCIONALE E STUDENTËVE TË UNT-SË NGA PROGRAMI STUDIMOR "PUNË DHE POLITIKË SOCIALE" NË INSTITUCIONET E MBROJTJES SOCIALE

Shkup, dhjetor 2025 – Studentët e vitit të III-të dhe të IV-të të Programit Studimor "Punë dhe Politikë Sociale", pranë Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, realizuan një vizitë studimore në Institucionin Publik për Përkujdesjen e Fëmijëve me Probleme Edukativo-Sociale dhe Sjellje të Çrregulluar në Shkup.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1FvnqSCWnr/>

VIZITË STUDIMORE E STUDENTËVE TË UNT-SË NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Shkup, dhjetor 2025 - Studentët e viteve të para, të dyta dhe të treta të programeve studimore "Studime të Drejtësisë", "Administratë Publike dhe Menaxhimi i Resurseve Humane" të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, realizuan një vizitë studimore në Gjykatën Administrative në Shkup. Kjo veprimtari u zhvillua në kuadër të realizimit praktik të lëndëve "E drejta administrative" dhe "Procedura administrative".

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/181x6ApZtg/>

UNT SHËNON 9-VJETORIN DHE NDERON AKADEMIK ALAJDIN ABAZIN ME TITULLIN "DOCTOR HONORIS CAUSA"

Shkup, 22.12.2025 - Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup organizoi sot një ceremoni solemne për të shënuar 9-vjetorin e fillimit të punës, kurorëzim për rrugëtimin e suksesshëm akademik të këtij institucioni. Ngjarja qendrore e këtij manifestimi ishte ndarja e titullit "Doctor Honoris Causa" për Akademik Prof. Dr. Alajdin Abazin, me motivacionin "për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në zhvillimin e kulturës, arsimit dhe kërkimit shkencor, si dhe për rolin e tij si një prej intelektualëve më të shquar të kombit shqiptar."



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/18EyeVRXVe/>

STUDENTËT E FAKULTETIT EKONOMIK TË UNT-SË VIZITË STUDIMORE NË BANKËN POPULLORE

Shkup, dhjetor 2025 - Studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup realizuan një vizitë studimore në Bankën Popullore të RMV-së, me qëllim njohjen nga afër me funksionimin e sistemit bankar dhe praktikatat bashkëkohore financiare.

Gjatë kësaj vizite, studentët dhe stafi akademik u pritën në mënyrë profesionale nga z. Artan Sulejmani dhe z. Gani Ramadani, të cilët ndanë informacione të vlefshme mbi aktivitetet dhe rolin rregullator të institucionit bankar qendror.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/189jeH7uxa/>

LIDHJA E TEORISË ME PRAKTIKËN, STUDENTËT E UNT-SË NDJEKIN SEANCË STËRVITORE NË KUADËR TË LËNDËS “SPORTET MUNDËSE”

Shkup, dhjetor 2025 – Studentët e vitit të katërt nga programi studimor Sport dhe Shkencat Sportive të Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, realizuan një vizitë studimore në ambientet e Klubit të Boksit “Shkupi”. Kjo vizitë u zhvillua në kuadër të realizimit të pjesës praktike të lëndës “Sportet Mundëse”.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1E89XahXvf/>

UNT DHE KOMISIONI I LETRAVE ME VLERË NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI PËR AVANCIMIN E EDUKIMIT FINANCIAR

Shkup, 23.12.2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup dhe Komisioni i Letrave me Vlerë në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë zyrtarizuar sot një partneritet strategjik përmes nënshkrimit të një Memorandumi Bashkëpunimi. Dokumenti u nënshkrua nga rektori i UNT-së, Prof. Dr. Bekim Fetaji, dhe kryetarja e Komisionit të Letrave me Vlerë, Mr. Bujare Abazi.



Ky memorandum synon të rregullojë dhe të parashikojë një bashkëpunim afatgjatë për zbatimin e projekteve të përbashkëta në fushën e edukimit profesional, kërkimit shkencor dhe praktikës studentore në sferën e tregjeve të kapitalit.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/18AC8TcqM9/>

REKTORI FETAJI, PJESEMARRËS NË SEANCËN E KATËRT TË KËSHILLIT NACIONAL PËR ZHVILLIM

Shkup, dhjetor 2025 - Rektori i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, Prof. Dr. Bekim Fetaji, mori pjesë sot në seancën e katërt të Këshillit Nacional për Zhvillim, të mbajtur në sallën solemne të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ky takim i nivelit të lartë, i kryesuar nga Kryeministri z. Hristijan Mickoski, mblodhi bashkë përfaqësuesit më të lartë të institucioneve shtetërore dhe rektorët e universiteteve publike në vend.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1CrcCBYkUg/>

STUDENTËT E UNT-SË VIZITË STUDIMORE NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Shkup, dhjetor 2025 - Studentët e programeve studimore të Drejtësisë, Kriminalistikës dhe



Administratës Publike të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, realizuan një vizitë studimore në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nën udhëheqjen e Mr. sc. Arifton Ramës të mirëpritur nga kryetari i Kuvendit, z. Afrim Gashi.

Gjatë vizitës, studentët u njohën nga afër me strukturën organizative, procedurat e hartimit të ligjeve dhe rolin e komisioneve parlamentare. Ky aktivitet shërbeu si një mundësi e shkëlqyer për të ndërlidhur njohuritë teorike akademike me praktikën institucionale.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1CLcez4Bh9/>

NË UNT PROMOVOHEN LIBRAT “STATIKA” DHE “DINAMIKA” TË AUTORIT PROF. INOR. DR. ISAK IDRIZI

Shkup, 25.12.2025 - Në një atmosferë solemne dhe akademike, Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, përkatësisht Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, organizoi promovimin e dy vëllimeve shkencore të autorit Prof. Inor. Dr. Isak Idrizi me titujt: “Mekanika Inxhinierike - Statika” dhe “Mekanika Inxhinierike - Dinamika”.

Evenimenti, i cili mbledhi bashkë udhëheqësinë e universitetit, stafin akademik, administrative, studentë, miq dhe dashamirë të librit u moderua nga profesoresha Genta Spahija Mirzo, e cila në fjalën e saj hapëse vuri në dukje rëndësinë e botimeve të tilla që shërbejnë si udhërrëfyes për brezat e rinj të inxhinierëve.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1GdwCi8jUa/>

MUNDËSI TË REJA PËR STUDENTËT E UNT-SË, NËNSHKRUHET MEMORANDUMI PËR QEVERISJE TË MIRË DHE PRAKTIKË PROFESIONALE



Shkup, 25.12.2025 - Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup dhe Kabineti i Zëvendëskryeministrit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, i ngarkuar për politikën e qeverisjes së mirë, kanë nënshkruar sot një Memorandum Mirëkuptimi me qëllim forcimin e bashkëpunimit institucional dhe rritjen e transparencës.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1SpN2Dq4GH/>

REZULTATE TË SHKËLQYERA NGA STUDENTËT E UNT-SË NË VLERËSIMIN PRAKTIK TË LËNDËS "ARMATIMI DHE PAJISJET"

Shkup, dhjetor 2025 - Studentët e programit studimor Kriminalistikë, pranë Fakultetit Juridik të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, kanë treguar rezultate impresive gjatë vlerësimit praktik të lëndës “Armatimi dhe pajisjet dhe Trajnimi me armë”.



Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1DpwsZzVHn/>



STUDENTËT E PSIKOLOGJISË NGA UNT REALIZOJNË MBI 20 VIZITA PRAKTIKE NË SHKOLLAT FILLORE



Shkup, Dhjetor 2025 - Studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale, të programit studimor Psikologji të vitit të II-të në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup kuadër të lëndës “Psikologjia Arsimore” udhëhequr nga Doc. Dr. Nita Beluli Luma, kanë realizuar me sukses mbi 20 vizita në shkolla të ndryshme fillore në qytetet, Shkup, Kumanovë dhe rrethinë.

Për më shumë ndiq vegëzën në vijim: <https://www.facebook.com/share/p/1C316YamAe/>



PULS I UNT-SË: BILANCI I SEMESTRIT DIMËROR

Shkup, 31 Dhjetor 2026

